



VITE PAS: [MOS]KONSOLIDIM I SHTETËSISË

Këndvështrimi i qytetarëve rreth
dialogut Kosovë - Serbi





VITE PAS: [MOS]KONSOLIDIM I SHTETËSISË

Këndvështrimi i qytetarëve rreth
dialogut Kosovë - Serbi

COPYRIGHT © 2017. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Disclaimer: Ky raport është rezultat i një hulumtimi që është realizuar në kuadër të projektit "Forcimi i mbikëqyrjes parlamentare të ekzekutivit dhe rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në dialogun Kosovë-Serbi", i financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE

6

2. METODOLOGJIA

7

3. PYETJET E SONDAZHIT

9

3.1

Në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi është arritur marrëveshja për drejtësi e cila parasheh integrimin e Gjykatave të veriut në sistemin gjyqësor të Kosovës. A konsideroni që integrimi do të jetë i suksesshëm?

3.1

A konsideroni që janë shuar strukturat paralele serbe në Kosovë?

3.2

A ka ndikuar dialogu Kosovë-Serbi që Kosova të shtrijë sovranitetin e saj në veri?

3.3

Cili mendoni se do të jetë ndikimi i Asociacionit të Komunave me shumicë Serbe në raportet ndëretnike në Kosovë?

4. PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME

18



HYRJE

Hulumtimi i opinionit publik “6 Vite pas mos(konsolidim) i shtetësisë: kënvështrimi i qytetarëve rreth dialogut Kosovë-Serbi” është hulumtimi i treti me rradhë që KDI organizon për të nxjerr në pah këndvështrimin e qytetarëve rreth këtij procesi.

Pas 6 vitesh dialog Kosovë-Serbi dhe 4 vite pas arritjes së marrëveshjes së parë për normalizimin e marrëdhënieve të 19 Prill 2013¹, ky sondazh synon të nxjerr në pah këndvështrimin e qytetarëve rreth çështjeve kryesore të cilat kanë ndjekur këtë proces që nga fillimi i tij. Përkatësisht shuarjen e strukturave paralele serbe në Kosovë dhe shtrirjen e sovranitetit të Kosovës në veri të vendit.

Gjithashtu ky sondazh fokusohet në dy prej marrëveshjeve kryesore të këtij procesi të cilat kanë zgjuar debat të madh shoqëror duke polarizuar edhe skenën politike, përkatësisht në marrëveshjen për drejtësi dhe në marrëveshjen për asocacionin e komunave me shumicë serbe.

¹ http://votaim.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes_19prill2013_HGX-f5EDTG4.pdf

Rezultatet e sondazhin reflektojnë nevojën për të rritur transparencën e procesit të dialogut Kosovë-Serbi. Gjithashtu reflektojnë nevojën për debat publik, për qasjen gjithëpërfshirëse dhe për seriozitet të shtuar në njoftimin e qytetarëve rreth marrëveshjeve të arritura, procesit të zbatimit të tyre dhe mbi të gjithë rreth efekteve që këto marrëveshje do të kenë në jetën e qytetarëve të Kosovës.

Në të njëjtën kohë ky sondazh reflekton qëndrimin e qytetarëve që konstaton që shuarja e strukturave paralele serbe si dhe shtrirja e sovranitetit shtetëror të Kosovës në tërë territorin e vendin mbeten çështje të cilat ende duhet të adresohet nga institucionet e vendit.

Këto sondazhe organizohen në kuadër të misionit të KDI-së për të promovuar transparencën, llogaridhënien dhe demokracinë e përgjegjshme. Ky projekt është i financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës për forcimin e mbikëqyrjes parlamentare të ekzekutivit dhe rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në dialogun Kosovë-Serbi.






2. METODOLOGJIA

Sondazhi është zhvilluar në nivel vendi duke përdorur metodën sistematike të rastësisë, me mostër prej 1065 të anketuarëve e dizajnuar për sigurimin e mostrës përfaqësuese, e shtresuar sipas etniciteteve: shqiptar, serb dhe

minoritete jo-serbe, shtrirja sipas vendbanimeve (ubane/rurale). Sondazhi është realizuar në periudhën kohore 03-12 Mars 2017. Margjina e gabimit është rreth $\pm 3\%$.



ky sondazh reflekton qëndrimin e qytetarëve që konstaton që shuarja e strukturave paralele serbe si dhe shtrirja e sovranitetit shtetëror të Kosovës në tërë territorin e vendin mbeten çështje të cilat ende duhet të adresohet nga institucionet e vendit.



3

**PYETJET E
SONDAZHIT**

3.1

Në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi është arritur marrëveshja për drejtësi e cila parasheh integrimin e Gjykatave të veriut në sistemin gjyqësor të Kosovës. A konsideroni që integrimi do të jetë i suksesshëm?

Marrëveshja e Drejtësisë është pjesë përbërëse e Marrëveshjes së parë për normalizimin e marrëdhënieve e arritur më 9 prill 2013, marrëveshje e cila u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Vit në të cilin pritej edhe zbatimi i saj.

Si rezultat i moszbatimit, pasuan diskutimet që kulmuan me Marrëveshjen për Gjyqësorin më 09 shkurt 2015 si dhe konkluzat e BE-së të arritura më 30 nëntor 2016. Data 10 janar 2017 pritej si datë për zbatimin e saj, kjo nuk ndodhi. Ende nuk ka një datë qoftë nga BE, qoftë nga institucionet e Republikës së Kosovës se kur kjo marrëveshje pritet të zbatohet plotësisht.

Në raportimin e tij para Kuvendit të Kosovës, kryeministri i vendit z. Isa Mustafa kishte deklaruar: “ ... me marrëveshjen për drejtësi nuk ka palë fituese dhe palë

humbëse. Me këtë marrëveshje ka fituar drejtësia, prandaj konsideroj se kanë fituar të gjitha palët, kanë fituar të gjithë qytetarët, ka fituar integriteti dhe sovraniteti i vendit tone”².

Nga ana tjetër, kjo marrëveshje është konsideruar nga Ministria e Dialogut znj. Edita Tahiri si një ndër marrëveshjet më të rëndësishme, me anë të së cilës do të bëhet konsolidimi i sovranitetit shtetëror të Kosovës dhe vendosja e sistemit unitar të drejtësisë në pjesë veriore të vendit si dhe shuarja e strukturave paralele serbe të drejtësisë në Kosovë³.

² <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,4729>, qasur më 17 Prill 2017

³ http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_2017_02_22_11_6867_al.pdf
Raportim i Ministres së Dialogut znj. Edita Tahiri në Komisionin Parlamentar për Legjislacion

A e konsiderojnë qytetarët e Kosovës që integrimi i gjykatave të veriut në sistemin gjyqësor të Kosovës do të jetë i suksesshëm?

Në bazë të sondazhit, 58% e të anketuarëve vlerësojnë se integrimi i gjykatave të veriut në sistemin gjyqësor të Kosovës nuk do të jetë i suksesshëm. Vetëm rreth 14% e të anketuarëve konsiderojnë që kjo marrëveshje do të arrijë ta unifikoj sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës.

Janë një numër i konsiderueshëm i qytetarëve përkatësisht 28% të cilët janë shprehur se nuk e dijnë nëse kjo marrëveshje do të arrijë të përmbushë objektivat e saj – integrimin e gjykatave të veriut në sistemin gjyqësor të Kosovës.

Nëse analizojmë perceptimin e qytetarëve në bazë të përkatësisë etnike, janë 60% e të anketuarëve nga komuniteti serb të cilët besojnë se integrimi i gjykatave serbe në veri nuk do të jetë i suksesshëm. Kjo karshi 58.2% të respondentëve nga komuniteti shqiptar dhe 50% të komuniteteve tjera joshumicë të cilët ndajnë të njëjtin qëndrim.

Nga ana tjetër, janë respondentët nga komuniteti shqiptar ata që në shkallë më të lartë përkatësisht 14.2% e tyre të cilët besojnë se integrimi i gjykatave të veriut në sistemin gjyqësor të Kosovës do të jetë i suksesshëm, karshi 10% të respondentëve nga komuniteti dhe 9% nga komunitetet e tjera jo shumicë.

Numri më i madh i të painformuarve rreth kësaj marrëveshjeje i përket respondentëve nga komunitetet tjera joshumicë në Kosovë përkatësisht 41% e tyre, kundrejt 30% të komunitetit serb dhe 27.6% të respondentëve të komunitetit shqiptar të cilët shprehen se nuk e dijnë nëse integrimin i gjykatave të veriut në sistemin gjyqësor të Kosovës do të jetë i suksesshëm.



3.2

A konsideroni që janë shuar strukturat paralele serbe në Kosovë?

Marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut ndërlidhen drejtpërdrejt me shuarjen e strukturave paralele serbe të financuara nga shteti i Serbisë të cilat kanë vazhduar të funksionojnë edhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, veçanërisht në veri të vendit.

Është synuar që me anë të këtyre marrëveshjeve të shuheshin strukturat paralele serbe, të shtrihej sovraniteti legal dhe legjitim i institucioneve të Kosovës në tërë territorin e vendit dhe të bëhej integrimi i komunitetit serb në këto institucione.

Ministria Tahiri si kryenegociatore nga ana e Qeverisë së Kosovës ka deklaruar në mënyrë të vazhdueshme se strukturat paralele janë shuar në fushat në të cilat janë arritur marrëveshje ⁴.

Ndërsa shtrirja dhe konsolidimi i sovranitetit të shtetit të Kosovës me anë të dialogut Kosovë-Serbi është përmën-

⁴ http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2017_02_09_10_6844_al.pdf

dur si në Rezolutat të cilat kanë kaluar në Kuvendin e Kosovës të cilat i kanë dhënë dritën e gjelbërt qeverisë për të negociuar ⁵, ashtu edhe në Platformën e Qeverisë për dialogun teknik me Serbinë ⁶, ku u konstatua se "dialogu teknik midis Kosovës dhe Serbisë do të konsolidojë pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës", si dhe në efektet që priten nga zbatimi i marrëveshjeve të dala nga ky proces.

Këto dy çështje kanë qenë tema të mospajtimeve të shumta në skenën politike të vendit, përfshirë edhe qëndrimet e kundërta nëse këto çështje duhet të diskutoheshin në kuadër të dialogut të Brukselit apo të adresoheshin në kuadër të dialogut të brendshëm politik.

⁵ Pika 3, Rezoluta Nr.04-R-08 Dialogu dhe rezultatet e tij duhet të jenë në pajtim me sovranitetin e Kosovës, subjektivitetin ndërkombëtar, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm unik kushtetues të Kosovës. http://ëëë.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezolute_Marredhenive_Kosova_Serbia.pdf

⁶ Qeveria e Republikës së Kosovës - Platforma e Qeverisë së Republikës së Kosovës për dialogun teknik ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë: http://votaim.e.org/Uploads/Data/Documents/PlatformaeQeverisesereRepublikesseKosovesperdialogunteknikmesKosovesdheSerbise_mars2011_652VRxëC6v.pdf (qasur me 04.04.2017)


Cili është këndvështrimi i qytetarëve rreth ndikimit të dialogut në shuarjen e strukturave paralele serbe?

Në pyetjen tonë se a konsiderojnë qytetarët se strukturat paralele serbe në Kosovë janë shuar, 48% e respondentëve kanë deklaruar se strukturat paralele serbe në Kosovë nuk janë shuar. Janë 30% e respondentëve të cilët kanë deklaruar se strukturat paralele serbe janë shuar vetëm në disa fusha, ndërsa vetëm 4% e respondentëve konsiderojnë që në Kosovë nuk funksionojnë më strukturat paralele të financuara nga shteti i Serbisë. Janë 18% e respondentëve të cilët kanë deklaruar se nuk e dinë nëse këto strukturat paralele në Kosovë janë shuar.

Sa i përket qëndrimit të respondentëve në bazë të përkatësisë së tyre etnike, 49% e respondentët nga komuniteti

shqiptar konsiderojnë që strukturat paralele serbe nuk janë shuar, krahas 33% të respondentëve nga komuniteti serb dhe 40% e komuniteteve jo shumicë që ndajnë të njëjtin qëndrim.

Vlen të theksohet që 30.1% e respondentëve nga komuniteti shqiptar dhe 30.7% e respondentëve nga komuniteti serb kanë deklaruar se strukturat paralele serbe janë shuar në disa fusha. Ndërsa janë 14% e respondentëve nga komuniteti serb që vlerësojnë që këto struktura janë shuar plotësisht krahasuar me 3.9% nga respondentët e komunitetit shqiptar dhe 4% e respondentëve nga komunitetet e tjera.



3.3

A ka ndikuar dialogu Kosovë-Serbi që Kosova të shtrijë sovranitetin e saj në veri të vendit?


Më shumë se gjysma e qytetarëve të anketuar, përkatësisht 51% e tyre kanë deklaruar se dialogu nuk ka ndikuar që shteti i Kosovës ta shtrijë sovranitetin e vet në veri të vendit. 27.6% e anketuarëve vlerësojnë që fal dialogut shteti i Kosovës ka arritur të shtrij sovranitetin e saj në

veri të vendit vetëm në disa fusha. Ndërsa janë vetëm 4.2% e qytetarëve që besojnë se dialogu ka ndikuar në shtrirjen e plotë të sovranitetit të shtetit të Kosovës në veri të vendit, krahasuar me 17% të qytetarëve të cilët nuk kanë qëndrim rreth kësaj çështje.

Nëse i analizojmë qëndrimet e respondentëve në bazë të përkatësive të tyre etnike, del në pah se shumica e respondentëve të komunitetit shqiptar përkatësisht 52% e tyre vlerësojnë se dialogu nuk ka ndikuar në shtrirjen e sovranitetit të shtetit të Kosovës në veri të vendit. Përkundrajt 32% të respondentëve të komunitetit serb dhe 44% të respondentëve të komuniteteve të tjera që ndajnë të njëjtin qëndrim.

Qytetarët e komunitetit serb në shkallë më të lartë përkatësisht 36.7% e tyre, kundrejt 27.7% e komuniteteve të tjera dhe 16% e komuniteteve të tjera të cilët vlerësojnë se me anë të dialogut sovraniteti i shtetit të Kosovës është shtrirë në veri të vendit në disa fusha.

Janë qytetarët nga komuniteti serb përkatësisht 13.3% e tyre që vlerësojnë që me anë të dialogut shteti i Kosovës ka arritur të shtrijë plotësisht sovranitetin e tij në veri të vendit krahasuar me vetëm 3.8% e qytetarëve nga komuniteti shqiptar dhe 6% e qytetarëve të komuniteteve të tjera.



3.4

Cili mendoni se do të jetë ndikimi i Asociacionit të Komunave me shumicë Serbe në raportet ndëretnike në Kosovë?

Themelimi i Asociacionit të Komunave me shumicë Serbe (ASK) në Kosovë vazhdon të mbetet ndër temat kryesore dhe më të debatuar në vend. E gjendur në udhëkryq, mes presionit ndërkombëtar për themelimin e këtij asociacioni dhe kundërshtimin e fuqishëm nga opozita, Qeveria e Republikës së Kosovës ende nuk ka filluar hartimin e statutit të këtij Asociacioni. Idea e themelimit të ASK-së shihet me skepticizëm edhe nga qytetarët e vendit, ku në sondazhin paraprak të organizuar nga KDI pjesa më e madhe e qytetarëve përkatësisht 36% e tyre konsideronin që Asociacioni i komunave me shumicë serbe do të ketë jetë mekanizëm me kompetenca ekzekutive ⁷.

⁷ <https://www.kdi-kosova.org/publikime/101-hulumtim-i-opinionit-publik-2-dialogu-dhe-mar-reveshjet-ne-syte-e-qytetareve.pdf>

Këtë herë, KDI ka pyetur qytetarët se si do të ndikoj themelimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe në raportet ndëretnike në Kosovë?

Shumica e respondentëve 46% konsiderojnë se Asociacioni i komunave me shumicë serbe do të ndikoj në përkeqësimin e raporteve ndëretnike në Kosovë. Janë 30.8% e respondentëve që vlerësojnë që raportet ndëretnike do të mbesin të njëjtat, ndërsa vetëm 5.2% e qytetarët verësojnë se ato do të përmirësohen. Ndërsa 17.9% e respondentëve nuk e dijnë se çfarë efekti do të ketë asociacioni i komunave me shumicë serbe në raportet ndëretnike në Kosovë.

Nëse analizojmë qëndrimin e qytetarëve në bazë të përkatësisë së tyre etnike del në pah se 47.2% e respondentëve nga komuniteti shqiptar vlerësojnë se asociacioni i komunave me shumicë serbe do ti përkeqësoj raportet ndëretnike përkundrejt 33.3% të respondentëve nga komuniteti serb dhe 24% e respondentëve nga komunitetet e tjera jo shumicë të cilat ndajnë këtë qëndrim.

Sa i përket qëndrimin të tyre se edhe pas themelimit të asosacionit të komunave me shumicë serbe raportet ndëretnike do të jenë të njëjta, nuk vihet re një

dallim i dukshëm në mes qytetarëve të përkatësive të ndryshme etnike ku 30.9% e qytetarëve nga komuniteti shqiptar, 30.7% e qytetarëve nga komuniteti serb dhe 27% e qytetarëve nga komunitetet e tjera ndajnë këtë qëndrim.

Vlen të theksohet që qytetarët nga komuniteti serb në shkallë më të lartë, përkatësisht 18% e tyre vlerësojnë që asocacioni i komunave me shumicë serbe do ti përmirësojnë raportet ndëretnike, përkundrejt 4.7% të qytetarëve nga komuniteti shqiptar dhe 8% nga komunitetet e tjera që ndajnë këtë qëndrim.



4. PËRFUNDIM

Në sondazhin e tretë me rradhë për matjen e perceptimit qytetar rreth dialogut Kosovë- Serbi, KDI ka adresuar çështjet kryesore dhe më të debatuar në vend rreth këtij procesi. Më konkretisht, KDI këtë herë ka trajtuar çështjen e shtrirjes së sistemit të drejtësisë në tërë territorin e vendit, të shpërbërjes së strukturave paralele serbe, të shtrirjes së sovranitetit të institucioneve të Kosovës në tërë territorin e vendit si dhe ndikimin e themelimit të Asociacionit të Komunave me shumicë Serbe në marrëdhënien ndëretnike.

Të gjeturat kryesore të këtij sondazhi janë si vijim:

- 1.** Pjesa më e madhe e qytetarëve të Kosovës, përkatësisht 46% e tyre, vlerësojnë se asociacioni i komunave me shumicë serbe mund të ndikojë në përkeqësimin e raporteve ndëretnike.
- 2.** Gjysma e qytetarëve të Kosovës, përkatësisht 51%, vlerësojnë se dialogu Kosovë-Serbi nuk ka ndikuar që Kosova të shtrijë sovranitetin e saj në veri të vendit. Janë vetëm 4% e qytetarëve që vlerësojnë se dialogu Kosovë-Serbi ka pasur ndikim në këtë aspekt
- 3.** Gjysma e qytetarëve të Kosovës, përkatësisht 48% e tyre, vlerësojnë se strukturat paralele serbe në Kosovë të financuara nga shteti i Serbisë nuk janë shuar. Vlen të theksohet që vetëm 4% e qytetarëve të Kosovës vlerësojnë që këto struktura paralele serbe janë shuar plotësisht pas 6 viteve të dialogut Kosovë-Serbi.
- 4.** Qytetarët e Kosovës në nivel të lartë, përkatësisht 58% e tyre, vlerësojnë se marrëveshja për drejtësi nuk do të jetë e suksesshme për të integruar gjykatat e veriut në sistemin qyjësor të Kosovës.

Rekomandime:

- 1.** KDI rekomandon që Marrëveshja e drejtësisë e aritur në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi të bëhet publike për qytetarët.
- 2.** KDI rekomandon që Qeveria dhe institucionet e drejtësisë në mënyra aktive të angazhohen për të rritur transparencën rreth Marrëveshjes së Drejtësisë ndaj qytetarëve që preken nga kjo marrëveshje, ndaj publikut të gjerë si dhe ndaj zyrtarëve të sistemit të drejtësisë të cilët do të operojnë në kuadër të kësaj marrëveshjeje.
- 3.** KDI i rekomandon Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës që procesi i zbatimit të marrëveshjeve të jetë më transparent për qytetarët e Kosovës dhe të ketë informim sistematik mbi shkallën e zbatueshmërisë së marrëveshjeve dhe efekteve të tyre të pritshme në terren.
- 4.** KDI i rekomandon Qeverisë së Kosovës të shtoj angazhimin e saj konkret për të shuar strukturat paralele serbe të financuara nga shteti i Serbisë në të gjitha fushat në tërë territorin e vendit.
- 5.** KDI i rekomandon institucioneve të Kosovës që të ndërmarrin të gjitha masat e domosdoshme për të garantuar shtrirjen e sovranitetit të shtetit në tërë territorin e vet.
- 6.** KDI rekomandon që Qeveria e Kosovës të garantojë një qasje gjithpërfshirëse dhe një transparencë të plotë për formimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, duke shtjelluar në detaje kompetencat e këtij mekanizmi, dhe duke garantuar një debat të mirëfilltë shoqëror rreth efekteve të tij.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo